



Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____ 2026

PËR

MIRATIMIN E MASAVE PËR ZBATIMIN E AKTIT PËR TREGJET DIGJITALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE RREGULLAT PËR PROMOVIMIN E DREJTËSISË DHE TRANSPARENCËS NË SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT ONLINE PËR PËRDORUESIT E BIZNESIT¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të kontribojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm në Republikën e Shqipërisë përmes rregullave që i sigurojnë përdoruesve biznes të shërbimeve ndërmjetëse online dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorrët e kërkimit, një mjedis të drejtë dhe transparent, si dhe mundësitë për mjete efektive.

¹Ky ligj përafrohet plotësisht me Rregulloren (BE) 2019/1150 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe të transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësitimit online", Numri CELEX: 32019R1150, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, Seria L 186, datë 11.7.2019, faqe 57–79, dhe përafrohet pjesërisht me Rregulloren (BE) 2022/1925 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2022, "Për tregje të kontestueshme dhe të drejta në sektorin digjital dhe për ndryshimin e Direktivave (BE) 2019/1937 dhe (BE) 2020/1828 (Akti për Tregjet Digjitale)" Numri CELEX: 32022R1925, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, Seria L 265, datë 12.10.2022, faqe 1–66.

- b) sigurimi i gatishmërisë operacionale të institucioneve shqiptare për bashkëpunimin, koordinimin dhe mbështetjen procedurale në zbatim të Rregullores (BE) 2022/1925, Akti i Tregjeve Digjitale, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- c) përgatitja e Autoritetit përgjegjës, për bashkëpunimin dhe koordinimin me Komisionin Evropian dhe për ushtrimin, nga data e anëtarësimit, të kompetencave të parashikuara në nenin 38, të Rregullores (BE) 2022/1925, Akti i Tregjeve Digjitale;

Neni 2

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i rregullave për promovimin e drejtësisë, transparencës dhe të mjeteve efektive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe për përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorët e kërkimit online, në përputhje me praktiken e Bashkimit Evropian dhe me angazhimin rajonal të parashikuar në nenin 20, të Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, të ratifikuar me ligjin nr. 50/2025;
- b) përcaktimi i masave kombëtare të gatishmërisë institucionale dhe rregullat e bashkëpunimit, të koordinimit dhe të mbështetjes procedurale për zbatimin e Rregullores (BE) 2022/1925, nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e ndërmjetësimit online dhe për motorët e kërkimit online sipas përcaktimeve në krerët II, III, IV dhe V të këtij ligji, që u ofrohen ose synohen t'u ofrohen:
 - a) përdoruesve të biznesit dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve që kanë vendin e themelimit ose vendbanimin në Republikën e Shqipërisë dhe që, nëpërmjet këtyre shërbimeve, u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve të vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një Palë tjetër të CEFTA-s; ose
 - b) përdoruesve të biznesit dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve që kanë vendin e themelimit ose vendbanimin në një Palë tjetër të CEFTA-s dhe që, nëpërmjet këtyre shërbimeve, u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve të vendosur në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky ligj, përsa parashikon në krerët II, III, IV dhe V të tij, nuk zbatohet për:
 - a) shërbimet e pagesave online;
 - b) mjetet e publicitetit online dhe shkëmbimet e publicitetit online, që nuk ofrohen me qëllim lehtësimi të nisjes së transaksioneve direkte dhe që nuk përfshijnë marrëdhënie kontraktore me konsumatorët.
3. Krerët VI dhe VII të këtij ligji, zbatohen nga autoriteti përgjegjës dhe organet e tjera publike shqiptare lidhur me masat për gatishmërinë institucionale, bashkëpunimin, koordinimin dhe mbështetjen procedurale në lidhje me zbatimin e Rregullores (BE) 2022/1925, Akti i Tregjeve Digjitale me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
4. Ky ligj nuk çënon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, tregtinë elektronike, mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e sekretit tregtar dhe shërbimet financiare.

5. Ky ligj nuk cënon zbatimin e legjislacionit në fuqi që ndalojnë ose sanksionojnë praktikën e njëanshme ose të padrejta tregtare për çështje që nuk rregullohen nga krerët II–V, të këtij ligji si dhe nga legjislacioni në fuqi për vlefshmërinë, lidhjen, efektet ose zgjidhjen e kontratës.

Neni 4 **Përkufizime**

1. Në kuptim të këtij ligji, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “përdorues biznesi” është çdo person fizik që vepron në cilësinë e tregtarit ose në kuadër të një veprimtarie profesionale, ose çdo person juridik që, nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, u ofron mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij;
- b) “shërbim ndërmjetësimi online” është shërbimi që plotëson njëkohësisht këto kushte:
 - i) përbën shërbim të shoqërisë së informacionit, në kuptim të ligjit nr. 10128, datë 11.5.2009, “Për tregtinë elektronike”, të ndryshuar;
 - ii) u mundëson përdoruesve të biznesit t’u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve, me qëllim lehtësimin e nisjes së transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet tyre, pavarësisht nga vendi ku përfundojnë faktikisht këto transaksione;
 - iii) u ofrohet përdoruesve të biznesit në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe përdoruesit të biznesit;
- c) “ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online” është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, shërbime ndërmjetësimi online për përdoruesit e biznesit;
- ç) “konsumator” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve;
- d) “motor kërkimi online” është shërbimi digjital që u mundëson përdoruesve të paraqesin kërkesa për të kryer kërkime, në parim, në të gjitha faqet e internetit ose në të gjitha faqet e internetit në një gjuhë të caktuar, mbi bazën e një kërkese për çdo temë, në formën e një fjale kyçe, kërkese me zë, fraze ose të dhëne tjetër, dhe që kthen rezultate në çdo format, në të cilin mund të gjendet informacioni i kërkuar;
- dh) “ofrues i motorit të kërkimit online” është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, motorë kërkimi online për konsumatorët;
- e) “përdorues i faqes së internetit të ndërmarrjes” është çdo person fizik ose juridik që përdor një ndërfaqe online, përfshirë faqen e internetit ose një pjesë të saj dhe aplikacionet, përfshirë aplikacionet për pajisjet e lëvizshme, për t’u ofruar mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij;
- ë) “renditje” është rëndësia relative që u jepet mallrave ose shërbimeve të ofruara nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, ose rëndësia që u jepet rezultateve të kërkimit nga motorët e kërkimit online, ashtu siç paraqiten, organizohen ose komunikohen nga ofruesi, pavarësisht nga mjetet teknologjike të përdorura për këtë paraqitje, organizim ose komunikim;
- f) “kontroll” është pronësia ose aftësia për të ushtruar ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës;
- g) “termit dhe kushtet” janë të gjitha kushtet, klauzolat ose specifikimet, pavarësisht nga emërtimi ose forma e tyre, që rregullojnë marrëdhënien kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesit të biznesit dhe që përcaktohen njëanshmërisht nga ofruesi. Karakteri i njëanshëm vlerësohet rast pas rasti, mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm, ku madhësia relative e palëve, fakti se është zhvilluar një

negociatë ose se disa dispozita janë negociuar dhe përcaktuar bashkërisht nuk janë, në vetvete, vendimtare;

- gj) “mallra dhe shërbime ndihmëse” janë mallrat dhe shërbimet që i ofrohen konsumatorit përpara përfundimit të një transaksioni të nisur në shërbimin e ndërmjetësimit online, si plotësim i mallit ose i shërbimit kryesor të ofruar nga përdoruesi i biznesit nëpërmjet këtij shërbimi;
- h) “ndërmjetësim” ka kuptimin e dhënë në ligjin në fuqi për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- i) “medium i qëndrueshëm” është çdo instrument që i mundëson përdoruesit të biznesit të ruajë informacionin që i drejtohet personalisht, në mënyrë të aksesueshme për referim të mëvonshëm dhe për një periudhë kohore të përshtatshme me qëllimet e informacionit, dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;
- j) “data e anëtarësimit” është data e hyrjes në fuqi e Traktatit të Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- k) “shtet anëtar” është çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian;
- l) “Palë e CEFTA-s” është një palë e Marrëveshjes për Ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, për të cilën zbatohet Vendimi nr. 2/2024 i Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, sipas nenit 54 të atij vendimi;
- ll) “Autoriteti” është Autoriteti i Konkurrencës, i krijuar sipas ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;
- m) “ministria” është ministria përgjegjëse për politikën digjitale dhe komunikimet elektronike;
- n) “Akti i Tregjeve Digjitale” është Rregullorja (BE) 2022/1925 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 shtator 2022, "Për tregje të kontestueshme dhe të drejta në sektorin digjital dhe për ndryshimin e Direktivave (BE) 2019/1937 dhe (BE) 2020/1828 (Akti për Tregjet Digjitale)";

2. Termat “*gatekeeper*”, “*shërbim thelbësor platforme*”, “*përdorues fundor*”, si dhe çdo term tjetër i përdorur në krerët VI dhe VII të këtij ligji, që nuk përkufizohet shprehimisht në pikën 1, të këtij neni, kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 2, të Aktit të Tregjeve Digjitale.

Neni 5

Autoriteti përgjegjës

1. Autoriteti i konkurrencës nga data e anëtarësimit, është autoriteti përgjegjës që ushtron funksionet e autoritetit kombëtar, që zbaton rregullat e konkurrencës të përmendura në nenin 1, paragrafi 6, të Aktit të Tregjeve Digjitale dhe kompetencat e parashikuara në nenin 38, të këtij akti.
2. Autoriteti i konkurrencës, ushtron kompetencat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.
3. Autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit dhe organet e tjera publike, sipas kompetencave të tyre dhe brenda përcaktimeve të legjislationit sektorial përkatës, bashkëpunojnë për përmbushjen e detyrave të parashikuara në krerët II deri në V, të këtij ligji.

KREU II

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE MARRËDHËNIA KONTRAKTUALE ME PËRDORUESIT E BIZNESIT

Neni 6

Kushtet e përgjithshme

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online siguron që kushtet e tij të përgjithshme:
 - a) të jenë hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme;
 - b) të jenë lehtësisht të disponueshme për përdoruesit e biznesit në të gjitha fazat e marrëdhënies së tyre tregtare me ofruesin, përfshirë fazën parakontraktore;
 - c) të përcaktojnë arsyet për vendimet për pezullimin, ndërprerjen ose vendosjen e çdo lloj kufizimi tjetër, tërësisht ose pjesërisht, mbi ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ndaj përdoruesve të biznesit;
 - ç) të përfshijnë informacion për çdo kanal shtesë shpërndarjeje dhe për çdo program të mundshëm bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave ofruesi mund të tregtojë mallrat dhe shërbimet e ofruara nga përdoruesit e biznesit;
 - d) të përfshijnë informacion të përgjithshëm për efektet e kushteve të përgjithshme mbi pronësinë dhe kontrollin e të drejtave të pronësisë intelektuale të përdoruesve të biznesit.
2. Kushtet e përgjithshme hartohen në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme që i mundësojnë përdoruesit mesatar të biznesit të kuptojë të drejtat, detyrimet dhe pasojat kryesore të marrëdhënies kontraktuale. Formulimet e paqarta, tepër të përgjithshme, mashtruese ose pa hollësitë e nevojshme për çështje të rëndësishme tregtare nuk e përmbushin këtë kërkesë.
3. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online siguron që identiteti i përdoruesit të biznesit që ofron mallra ose shërbime nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online të jetë qartësisht i dukshëm.
4. Kushtet e përgjithshme ose dispozitat e veçanta të tyre që nuk përmbushin kërkesat e pikës 1, të këtij neni janë absolutisht të pavlefshme dhe konsiderohen sikur nuk kanë ekzistuar. Pavlefshmëria përfshin vetëm dispozitat që nuk i përmbushin këto kërkesa; pjesa tjetër e kushteve të përgjithshme mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme, nëse mund të veçohet prej tyre.

Neni 7

Ndryshimi i kushteve të përgjithshme

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online njofton, në një medium të qëndrueshëm, përdoruesit e biznesit të prekur për çdo ndryshim të propozuar të kushteve të përgjithshme.
2. Ndryshimet e propozuara nuk zbatohen përpara skadimit të një afati njoftimi që është i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën dhe shkallën e ndryshimeve të parashikuara dhe me pasojat e tyre për përdoruesin e biznesit. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga data në të cilën ofruesi njofton përdoruesit e biznesit për ndryshimet e propozuara. Kur ndryshimet e propozuara kërkojnë nga përdoruesi i biznesit të bëjë përshtatje teknike ose tregtare të rëndësishme, jepen afate njoftimi më të gjata.

3. Përdoruesi i biznesit ka të drejtë të zgjidhë kontratën me ofruesin përpara skadimit të afatit të njoftimit. Zgjidhja prodhon efekte brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit sipas pikës 1, të këtij neni, përveç kur për kontratën zbatohet një afat më i shkurtër.
4. Përdoruesi i biznesit mund të heqë dorë nga afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, në çdo kohë pas marrjes së njoftimit, me deklaratë me shkrim ose me veprim të qartë konfirmues. Paraqitja e mallrave ose e shërbimeve të reja në shërbimin e ndërmjetësimit online gjatë afatit të njoftimit konsiderohet veprim i qartë konfirmues për heqjen dorë nga afati i njoftimit, përveç rastit kur afati i arsyeshëm dhe proporcional i njoftimit është më i gjatë se 15 ditë, për shkak se ndryshimet e kushteve të përgjithshme kërkojnë nga përdoruesi i biznesit përshtatje teknike të rëndësishme të mallrave ose të shërbimeve të tij.
5. Afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2, të këtij neni nuk zbatohet kur ofruesi:
 - a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron ta ndryshojë kushtet e tij të përgjithshme në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë afatin e njoftimit;
 - b) duhet t'i ndryshojë përjashtimisht kushtet e tij të përgjithshme për t'u përballur me një rrezik të paparashikuar dhe të menjëhershëm, që lidhet me mbrojtjen e shërbimit të ndërmjetësimit online, të konsumatorëve ose të përdoruesve të biznesit nga mashtrimi, programet keqdashëse, mesazhet e padëshiruara, shkeljet e të dhënave ose nga rreziqe të tjera për sigurinë kibernetike.
6. Ndryshimet e kushteve të përgjithshme, të zbatuara nga ofruesi në kundërshtim me këtë nen, janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 8

Kufizimi, pezullimi dhe ndërprerja e shërbimit

1. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online vendos të kufizojë ose të pezullojë ofrimin e shërbimeve të tij për një përdorues biznesi të caktuar, në lidhje me mallra ose shërbime të veçanta të ofruara nga ky përdorues, ai i jep përdoruesit të biznesit, përpara ose në çastin e fillimit të zbatimit të kufizimit ose të pezullimit, një deklaratë me arsyet e vendimit, në një medium të qëndrueshëm.
2. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online, vendos të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij për një përdorues biznesi të caktuar, ai i jep përdoruesit të biznesit, të paktën 30 ditë përpara fillimit të zbatimit të ndërprerjes, një deklaratë me arsyet e vendimit, në një medium të qëndrueshëm.
3. Në rastet e kufizimit, pezullimit ose ndërprerjes, ofruesi i jep përdoruesit të biznesit mundësinë të sqarojë faktet dhe rrethanat në kuadër të sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, sipas nenit 15, të këtij ligji. Kur masa revokohet, ofruesi e rikthen pa vonesë të pajustificuar përdoruesin e biznesit në gjendjen e mëparshme, duke i mundësuar qasjen në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, të gjeneruara nga përdorimi i shërbimeve përpara fillimit të zbatimit të masës.
4. Afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2, të këtij neni nuk zbatohet kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online:

- a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij të ndërmjetësimit online për një përdorues biznesi të caktuar, në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë këtë afat;
- b) ushtron një të drejtë ndërprerjeje për një arsye të detyrueshme, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) mund të provojë se përdoruesi i biznesit në fjalë ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme, çka ka sjellë ndërprerjen e ofrimit të të gjitha shërbimeve të ndërmjetësimit online në fjalë.

Në rastet e parashikuara në këtë pikë, ofruesi i jep përdoruesit të biznesit, pa vonesë të pajustificuar, deklaratën me arsyet e vendimit, në një medium të qëndrueshëm.

5. Deklarata me arsyet, e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 4 të këtij neni, përmban referimin në faktet ose rrethanat konkrete, përfshirë përmbajtjen e njoftimeve të palëve të treta, që kanë çuar në vendimin e ofruesit, si dhe referimin në arsyet e zbatueshme për këtë vendim, të parashikuara në kushtet e përgjithshme sipas nenit 6, pika 1, shkronja "c", të këtij ligji. Ofruesi nuk është i detyruar të japë deklaratën me arsyet kur i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator për të mos zbuluar faktet ose rrethanat konkrete a referimin në arsyet e zbatueshme, ose kur mund të provojë se përdoruesi i biznesit ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme.

Neni 9

Kushte kontraktuale të veçanta

Për të siguruar që marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të biznesit të zhvillohen në mirëbesim dhe mbi bazën e trajtimit të drejtë, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online:

- a) nuk imponon ndryshime me efekt prapaveprues të kushteve të përgjithshme, përveçse kur ato kërkohen për përmbushjen e një detyrimi ligjor ose rregullator, ose kur ndryshimet me efekt prapaveprues janë në dobi të përdoruesve të biznesit;
- b) siguron që kushtet e tij të përgjithshme të përmbajnë informacion për kushtet, në të cilat përdoruesit e biznesit mund ta zgjidhin marrëdhënien kontraktuale me ofruesin;
- c) përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, në informacionin e dhënë ose të gjeneruar nga përdoruesi i biznesit, të cilin ofruesi e ruan pas mbarimit të kontratës ndërmjet tij dhe përdoruesit të biznesit.

KREU III

TRANSPARENCA

Neni 10

Renditja

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përcakton në kushtet e tij të përgjithshme parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen, si dhe arsyet e rëndësisë relative të këtyre parametrave kryesorë në krahasim me parametrat e tjerë.

2. Ofruesi i motorit të kërkimit online përcakton parametrat kryesorë që, veçmas ose së bashku, janë më të rëndësishëm për përcaktimin e renditjes, si dhe rëndësinë relative të tyre, duke vënë në dispozicion të publikut, në motorin e tij të kërkimit online, një përshkrim lehtësisht të aksesueshëm, të hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Ofruesi e mban të përditësuar këtë përshkrim.
3. Kur parametrat kryesorë përfshijnë mundësinë e ndikimit mbi renditjen kundrejt çdo shpërblimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të paguar nga përdoruesit e biznesit ose nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve të ofruesit përkatës, ofruesi paraqet edhe një përshkrim të kësaj mundësie dhe të efekteve që ka ky shpërblim mbi renditjen, në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni.
4. Kur ofruesi i motorit të kërkimit online, në një rast të caktuar ka ndryshuar renditjen, ose ka hequr nga lista e rezultateve një faqe interneti të caktuar, pas një njoftimi të palës së tretë, ai i ofron përdoruesit të faqes së internetit të ndërmarrjes mundësinë të shqyrtojë përmbajtjen e njoftimit.
5. Përshkrimet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni janë të mjaftueshme për t'u mundësuar përdoruesve të biznesit ose përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve të kuptojnë në mënyrë të përshtatshme nëse dhe, kur po, në ç'mënyrë dhe në ç'masë mekanizmi i renditjes merr parasysh:
 - a) karakteristikat e mallrave dhe të shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online;
 - b) rëndësinë e këtyre karakteristikave për konsumatorët;
 - c) për motorët e kërkimit online, karakteristikat e strukturës së faqes së internetit të përdorur nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve.
6. Në përmbushjen e kërkesave të këtij neni, ofruesi nuk është i detyruar të zbulojë algoritmet ose çdo informacion që, me siguri të arsyeshme, do të mundësonte mashtrimin ose dëmtimin e konsumatorëve nëpërmjet manipulimit të rezultateve të kërkimit. Ky nen nuk çënon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e sekretit tregtar.

Neni 11

Mallrat dhe shërbimet ndihmëse

Kur konsumatorëve u ofrohen mallra dhe shërbime ndihmëse, përfshirë shërbimet financiare, nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online, qoftë nga vetë ofruesi i shërbimit, qoftë nga palë të treta, ofruesi përcakton në kushtet e tij të përgjithshme llojin e mallrave dhe të shërbimeve ndihmëse që ofrohen, si dhe nëse është rasti, në cilat kushte përdoruesit të biznesit i lejohet të ofrojnë mallrat ose shërbimet e veta ndihmëse nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online.

Neni 12

Trajtimi i diferencuar

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që ofron, ose mund të ofrojë, ndërmjet mallrave ose shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet këtyre shërbimeve, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga përdoruesit e biznesit që ai kontrollon, dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të biznesit. Përshkrimi u referohet konsideratave kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për këtë trajtim të diferencuar.
2. Ofruesi i motorit të kërkimit online paraqet një përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që ofron, ose mund të ofrojë, ndërmjet mallrave ose shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet motorit të kërkimit online, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga përdoruesit e faqeve të

internetit të ndërmarrjeve që ai kontrollon, dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve.

3. Përshkrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni mbulojnë, në veçanti, kur është rasti, çdo trajtim të diferencuar nëpërmjet masave të veçanta të marra nga ofruesi ose nëpërmjet sjelljes së tij, që lidhet me:
 - a) qasjen që ofruesi, ose përdoruesit e biznesit apo përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve që ai kontrollon, mund të kenë në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit, përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimit të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online, ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve;
 - b) renditjen ose cilësimet e tjera të zbatuara nga ofruesi, që ndikojnë në qasjen e konsumatorëve në mallrat ose shërbimet e ofruara nga përdoruesit e tjerë të biznesit ose nga përdoruesit e tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve;
 - c) çdo shpërblim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online;
 - ç) qasjen, kushtet ose çdo shpërblim të drejtpërdrejtë a të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve, të funksionaliteteve ose të ndërfaqeve teknike që janë të rëndësishme për përdoruesin e biznesit ose për përdoruesin e faqes së internetit të ndërmarrjes dhe që lidhen drejtpërdrejt ose në mënyrë ndihmëse me përdorimin e shërbimeve në fjalë.

Neni 13

Qasja në të dhëna

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, të përdoruesve të biznesit në çdo të dhënë personale ose të dhënë tjetër, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve.
2. Nëpërmjet përshkrimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ofruesi i informon në mënyrë të përshtatshme përdoruesit e biznesit, në veçanti, për sa vijon:
 - a) nëse ofruesi ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të tyre dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte;
 - b) nëse përdoruesi i biznesit ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që jep vetë në lidhje me përdorimin e shërbimeve ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të dhe për konsumatorët e mallrave ose të shërbimeve të tij dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte;
 - c) përveç shkronjës "b" të kësaj pike, nëse përdoruesi i biznesit ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, përfshirë në formë të përmbledhur, që jepen ose gjenerohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të gjithë përdoruesit e biznesit dhe për konsumatorët e tyre dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte;

- ç) nëse të dhënat e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike u jepen palëve të treta, së bashku me qëllimin e dhënies së tyre dhe me mundësitë e përdoruesit të biznesit për të mos e lejuar këtë dhënie, kur ajo nuk është e nevojshme për funksionimin e duhur të shërbimeve të ndërmjetësimit online.

3. Ky nen nuk çënon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 14

Kufizimet për ofrimin e kushteve të ndryshme me mjete të tjera

1. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online, gjatë ofrimit të shërbimeve të tij, kufizon aftësinë e përdoruesve të biznesit për t'u ofruar konsumatorëve të njëjtat mallra dhe shërbime me kushte të ndryshme, me mjete të tjera nga këto shërbime, ai përfshin arsyet e këtij kufizimi në kushtet e tij të përgjithshme dhe i vë ato lehtësisht në dispozicion të publikut. Arsyet përfshijnë konsideratat kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për kufizimin.
2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni nuk cenon asnjë ndalim ose kufizim për vendosjen e kufizimeve të tilla, që rrjedh nga zbatimi i legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe atë për praktikën e padrejta tregtare.

KREU IV

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 15

Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave

1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ngre një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave të përdoruesve të biznesit. Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm dhe pa pagesë për përdoruesit e biznesit.
2. Sistemi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, siguron trajtimin e ankesave brenda një afati të arsyeshëm. Ai bazohet në parimet e transparencës dhe të trajtimit të barabartë në situata të ngjashme si dhe në trajtimin e tyre në mënyrë proporcionale me rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre.
3. Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave i mundëson përdoruesit të biznesit paraqitjen direkte të ofruesit të ankesës në lidhje me:
 - a) mospërbushjen e pretenduar nga ofruesi të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, që ndikon te ankuesi;
 - b) çështjet teknologjike që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi;
 - c) masat e marra ose sjelljen e ofruesit, që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi.
4. Si pjesë e sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, ofruesi:
 - a) shqyrton me kujdes ankesat e paraqitura dhe masat e ndjekjes që mund të jenë të nevojshme për zgjidhjen e duhur të çështjes së ngritur;
 - b) i përpunon ankesat shpejt dhe në mënyrë efektive, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre;

- c) i komunikon ankuesit, në mënyrë të individualizuar dhe në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, rezultatin e procesit të brendshëm të trajtimit të ankesës.
5. Ofruesi përfshin në kushtet e tij të përgjithshme të gjithë informacionin e nevojshëm për aksesin në sistemin e brendshëm të trajtimit të ankesave dhe për funksionimin e tij.
 6. Ofruesi harton dhe vë lehtësisht në dispozicion të publikut informacionin për funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të tij të brendshëm të trajtimit të ankesave. Ai e verifikon këtë informacion të paktën një herë në vit dhe e përditëson atë kur nevojiten ndryshime të rëndësishme. Informacioni përmban numrin e përgjithshëm të ankesave të paraqitura, llojet kryesore të ankesave, kohën mesatare të nevojshme për përpunimin e tyre dhe informacion të përmbledhur për rezultatin e ankesave.
 7. Ky nen nuk zbatohet kur ofruesi i shërbimit është ndërmarrje e vogël ose mikrondërmarrje, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

Neni 16

Ndërmjetësimi

1. Për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online identifikon në kushtet e tij të përgjithshme dy ose më shumë ndërmjetës, me të cilët është i gatshëm të angazhohet për të arritur një marrëveshje me përdoruesit e biznesit për zgjidhjen jashtëgjyqësore të çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit të biznesit, që lind në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online, përfshirë ankesat që nuk kanë mundur të zgjidhen nëpërmjet sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, të parashikuar në nenin 15 të këtij ligji.
2. Në identifikimin e ndërmjetësive sipas pikës 1, të këtij neni, ofruesi i shërbimit mban parasysht përmbushjen e kërkesave të legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin.
3. Pavarësisht nga natyra vullnetare e ndërmjetësimit, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesit e biznesit veprojnë në mirëbesim gjatë çdo përpjekjeje për ndërmjetësim të ndërmarrë sipas këtij neni, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin.
4. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online, paguajnë tarifa të arsyeshme për shërbimin e ndërmjetësimit të miratuara sipas parashikimeve në legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin.
5. Çdo përpjekje për arritjen e një marrëveshjeje me ndërmjetësim për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje sipas këtij neni nuk prek të drejtat e ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe të përdoruesve të biznesit të prekur për të filluar procedura gjyqësore në çdo kohë përpara, gjatë ose pas procesit të ndërmjetësimit.
6. Me kërkesë të një përdoruesi biznesi, përpara hyrjes në ndërmjetësim ose gjatë tij, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online i vë në dispozicion përdoruesit të biznesit informacion për funksionimin dhe efektivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me veprimtaritë e tij.
7. Përcaktimet e pikës 1, sipas këtij neni, nuk janë detyruese për ndërmarrjet e vogla dhe mikrondërmarrjet sipas përcaktimeve në ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

Neni 17

Ndërmjetësit e specializuar

Autoriteti, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë, nxit ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësitimit online dhe organizatat e shoqatat që i përfaqësojnë ata që të krijojnë, veçmas ose së bashku, një ose më shumë organizata që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi të specializuara për mosmarrëveshjet me përdoruesit e biznesit, duke marrë parasysh natyrën ndërkufitare të shërbimeve.

KREU V

ZBATIMI DHE MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 18

E drejta e ankimit gjyqësor

1. Organizatat dhe shoqatat që kanë interes të ligjshëm në përfaqësimin e përdoruesve të biznesit ose të përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve, si dhe organet publike të ngarkuara shprehimisht me ligj, kanë të drejtë të ngrenë padi para gjykatës kompetente të juridiksionit të përgjithshëm për ndalimin ose pushimin e mospërmblidhjes, nga ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësitimit online ose nga ofruesit e motorëve të kërkimit online, të detyrimeve të parashikuara në krerët II, III dhe IV të këtij ligji.
2. Organizatat dhe shoqatat kanë të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vetëm nëse, në momentin e ngritjes së padisë, plotësohen kërkesat ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për paditë përfaqësuese në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian.
3. E drejta e parashikuar në pikën 1, nuk çënon të drejtën e përdoruesve të biznesit dhe të përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve për t'iu drejtuar gjykatës kompetente, mbi bazën e të drejtave të tyre individuale, për ndalimin ose pushimin e mospërmblidhjes dhe, kur plotësohen kushtet e përgjegjësisë civile, për shpërblimin e dëmit.

Neni 19

Kodet e sjelljes

1. Autoriteti dhe ministria përgjegjëse për ekonominë dhe ministria përgjegjëse për komunikimet elektronike bashkëpunojnë për:
 - a) inkurajimin e hartimit të kodeve të sjelljes nga ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësitimit online dhe nga organizatat e shoqatat që i përfaqësojnë ata, së bashku me përdoruesit e biznesit, përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe organizatat e tyre përfaqësuese, me qëllim kontributin në zbatimin e duhur të këtij ligji, duke marrë parasysh veçoritë e sektorëve të ndryshëm, në të cilët ofrohen shërbimet e ndërmjetësitimit online, si dhe karakteristikat e veçanta të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

- b) nxitjen e ofruesve të motorëve të kërkimit online dhe organizatave e shoqatave që i përfaqësojnë ata që të hartojnë kode sjelljeje, të cilat synojnë në mënyrë të veçantë të kontribuojnë në zbatimin e duhur të nenit 10, të këtij ligji.
- c) nxitjen e ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online që të miratojnë dhe të zbatojnë kode sjelljeje sektoriale, kur kode të tilla ekzistojnë dhe përdoren gjerësisht.

Neni 20

Mbikëqyrja dhe masat korrigjuese

1. Autoritetet përgjegjëse sipas pikës 3, të nenit 5, brenda fushës së vet të përgjegjësisë mbikëqyrin zbatimin e dispozitave të krerëve II, III dhe IV, të këtij ligji.
2. Kur autoriteti përgjegjës konstaton se ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ose ofruesi i motorit të kërkimit online nuk ka përmbushur një detyrim të parashikuar në krerët II, III ose IV, njofton ofruesit e shërbimit mbi mospërmbushjen e konstatuar, dhe me vendim të arsyetuar kërkon marrjen e masave korrigjuese brenda një afati të arsyeshëm kohor.
3. Nëse në përfundim të afatit kohor sipas pikës 2, të këtij neni, mospërmbushja vijon, autoriteti përgjegjës merr masa administrative si më poshtë:
 - a) kur shkelja bie në klauzolat e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, masat merren nga Autoriteti i Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës;
 - b) kur shkelja çënon të drejtat e konsumatorit, masat merren sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.
4. Masat administrative duhet të jenë proporcionale, efektive dhe dekurajuese. Autoriteti përgjegjës në dhënien e masave merr parasysh natyrën, rëndësinë, kohëzgjatjen dhe përsëritjen e mospërmbushjes, dëmin e shkaktuar ose të mundshëm për përdoruesit e biznesit, sjelljen e ofruesit gjatë procedimit, bashkëpunimin e tij dhe masat e marra për përfundimin e mospërmbushjes e riparimin e pasojave.
5. Masat apo vendimet e autoritetit përgjegjës sipas këtij neni, ankimohen në gjykatën administrative kompetente.

KREU VI

ZBATIMI I AKTIT TE TREGJEVE DIGJITALE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Neni 21

Autoriteti përgjegjës për bashkëpunimin me Komisionin Evropian

1. Autoriteti i Konkurrencës është autoriteti përgjegjës për bashkëpunimin me Komisionin Evropian, për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë.
2. Deri në datën e anëtarësimit, bashkëpunimi sipas pikës 1, të këtij neni përfshin, në veçanti:
 - a) pjesëmarrjen në programet e asistencës teknike dhe të ngritjes së kapaciteteve;
 - b) shkëmbimin e informacionit dhe të praktikave më të mira;
 - c) pjesëmarrjen në dialogun teknik me institucionet e Bashkimit Evropian.
3. Nga data e anëtarësimit, Autoriteti bashkëpunon dhe bashkërendon me Komisionin Evropian dhe me autoritetet e tjera kompetente të shteteve anëtare nëpërmjet Rrjetit Evropian të

Konkurrencës, sipas neneve 37 dhe 38 të Aktit për Tregjet Digjitale, në përputhje me përcaktimet e këtij akti.

Neni 22

Ndihma për ushtrimin e kompetencave të Komisionit Evropian

1. Nga data e anëtarësimit, Autoriteti, me kërkesë të Komisionit Evropian:
 - a) i vë në dispozicion çdo informacion të nevojshëm për ushtrimin e kompetencave të Komisionit, sipas nenit 21, të Aktit për Tregjet Digjitale;
 - b) ndihmon në zhvillimin e intervistave dhe marrjen e deklarimeve, sipas nenit 22, të Aktit për Tregjet Digjitale;
 - c) ofron ndihmë gjatë inspektimeve që Komisioni Evropian kryen në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 23, të Aktit për Tregjet Digjitale, përfshirë sigurimin e mbështetjes së organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjit, kur kjo është e nevojshme;
 - ç) mbështet zhvillimin e hetimeve të tregut, sipas nenit 16, paragrafit 5, të Aktit për Tregjet Digjitale;
 - d) vë në dispozicion të Komisionit Evropian zyrtarë për të asistuar në monitorimin e përmbushjes së detyrimeve dhe zbatimin e masave, sipas nenit 26, paragrafit 2, të Aktit për Tregjet Digjitale.
2. Në ushtrimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, autoriteti respekton kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për konkurrencën.

Neni 23

Hetimet me nismë të Autoritetit

1. Nga data e anëtarësimit, Autoriteti, mund të kryejë, me nismën e tij sipas legjislacionit në fuqi, hetime për raste të mospërputhjes së mundshme me nenet 5, 6 dhe 7, të Aktit për Tregjet Digjitale në territorin e Shqipërisë, sipas nenit 38, paragrafi 7, të Aktit për Tregjet Digjitale.
2. Përpara marrjes së masës së parë formale hetimore sipas pikës 1, të këtij neni, Autoriteti njofton me shkrim Komisionin Evropian.
3. Gjetjet e hetimit i përcillen Komisionit Evropian. Autoriteti nuk merr vendime për konstatimin e shkeljeve të Aktit për Tregjet Digjitale dhe nuk vendos sanksione për shkeljen e tij.
4. Kur Komisioni Evropian fillon një procedurë sipas Aktit për Tregjet Digjitale për të njëjtën sjellje objekt hetimi, Autoriteti nuk fillon ose, sipas rastit, ndërpret hetimin e nisur sipas këtij neni.
5. Kur Autoriteti fillon procedim ndaj një "gatekeeper-i" sipas legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, njofton me shkrim Komisionin Evropian, sipas nenit 38 të Aktit për Tregjet Digjitale.

Neni 24

Informacioni nga palët e treta

1. Çdo person fizik ose juridik mund t'i paraqesë Autoritetit informacion për praktika ose sjellje të gatekeeper-ve që hyjnë në fushën e zbatimit të Aktit për Tregjet Digjitale, sipas nenit 27 të tij.
2. Deri në datën e anëtarësimit, informacioni i marrë sipas pikës 1, të këtij neni përdoret për qëllime të monitorimit të tregjeve digjitale, të ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe të bashkëpunimit me Komisionin Evropian.
3. Nga data e anëtarësimit, Autoriteti shqyrton informacionin e marrë dhe, sipas rastit, merr masat që parashikohen në këtë ligj ose ia përcjell atë Komisionit Evropian.
4. Autoriteti krijon dhe administron një kanal të posaçëm komunikimi për marrjen e informacionit sipas këtij neni dhe informon publikun për funksionimin e tij.

Neni 25

Informacioni për përqendrimet

1. Gjatë shqyrtimit të përqendrimeve sipas legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, ku merr pjesë një gatekeeper ose një ndërmarrje që ofron shërbime thelbësore platforme ne Shqipëri, Autoriteti merr në konsideratë informacionin e njoftuar Komisionit Evropian sipas nenit 14 të Aktit për Tregjet Digjitale.
2. Nga data e anëtarësimit, informacioni i marrë nga Komisioni Evropian sipas nenit 14, të Aktit për Tregjet Digjitale përdoret nga Autoriteti për ushtrimin e kompetencave të tij në fushën e kontrollit të përqendrimeve, sipas legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës.

KREU VII

MASAT PËRGATITORE

Neni 26

Plani i gatishmërisë operacionale

1. Autoriteti miraton, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Planin e Gatishmërisë Operacionale për zbatimin e Rregullores (BE) 2022/1925.
2. Autoriteti e harton Planin pas konsultimit me autoritetet e tjera publike që, sipas kompetencave të tyre, kanë ekspertizën dhe informacionin e nevojshëm për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale dhe që mund të kontribuojnë sipas këtij ligji. Përfshirja në Plan e një mase që kërkon veprim nga një organ tjetër bëhet vetëm me pëlqimin e tij me shkrim dhe brenda kompetencave e burimeve që ai administron.
3. Plani përcakton, për çdo masë, rezultatit e pritshëm, afatin, strukturën përgjegjëse brenda Autoritetit, burimet dhe treguesin e realizimit deri në datën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian sipas kërkesave të Aktit të Tregjeve Digjitale.
4. Plani i përgatitur nga Autoriteti përditësohet kur ndryshojnë nevojat operacionale, faza e procesit të integritetit evropian.
5. Për realizimin e planit të gatishmërisë operacionale, autoriteti paraqet pranë kuvendit dhe/ose institucioneve përgjegjëse kërkesat për sigurimin/miratimin e burimeve të nevojshme.

Neni 27

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale

1. Autoriteti, sipas nevojave të përcaktuara në Planin e Gatishmërisë Operacionale, organizon trajnime dhe zhvillimin profesional të punonjësve të tij.
2. Në veprimtaritë trajnuese mund të marrin pjesë punonjës të organeve të tjera publike. Autoriteti mund të përdorë instrumentet e asistencës së Bashkimit Evropian, mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me autoritetet homologe.
3. Organe të tjera publike mund t'i ofrojnë Autoritetit ekspertë ose mbështetje teknike, me kërkesë të tij dhe brenda kompetencave e burimeve të tyre. Ky parashikim nuk u krijon atyre funksione të reja.

KREU VIII

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA, KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale në zbatim të këtij ligji kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Autoriteti dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, për çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale që lindin nga zbatimi i këtij ligji.

Neni 29

Ruajtja e konfidencialit tregtar

1. Informacioni i mbledhur në zbatim të këtij ligji, përdoret vetëm për qëllimet e këtij ligji, sipas bazës ligjore përkatëse.
2. Nga data e anëtarësimit, informacioni i shkëmbyer sipas nenit 38, të Rregullores, Akti i Tregjeve Digjitale përdoret vetëm për bashkërendimin e zbatimit të asaj rregulloreje dhe të rregullave të konkurrencës të përmendura në nenin 1, paragrafi 6, të saj. Informacioni i marrë sipas nenit 14 të përdoret vetëm për qëllimet e lejuara nga paragrafi 5 i atij neni.
3. Anëtarët e organeve drejtuese dhe punonjësit e Autoritetit e të organeve të tjera publike, si dhe çdo person tjetër që merr dijeni për informacion konfidencial, sekret profesional ose sekret tregtar gjatë zbatimit të këtij ligji, janë të detyruar ta ruajnë atë edhe pas përfundimit të funksionit ose të marrëdhënies së punës. Vendimet dhe raportet publikohen në version jokonfidencial.

Neni 30

Efektet financiare

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji përballohen nga buxheti i miratuar i Autoritetit dhe i institucioneve të tjera përgjegjëse. Programet e asistencës së Bashkimit Evropian ose të organizatave ndërkombëtare përdoren sipas legjislacionit për menaxhimin financiar dhe nuk çenojnë pavarësinë e Autoritetit.

Neni 31

Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e krerëve II, III dhe IV të këtij ligji zbatohen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Nga data e anëtarësimit, krerët II–V, të këtij ligji shfuqizohen me zbatimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.